



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 13.05.2013
Nr. 0202-408

PËR Bojan Stojanovic, Kryetari i Komunës së Graçanicës
Goran Lazic, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës

**LËNDA: KËRKESE PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË UDHËZIMIT PËR
POLOTSIMIN-NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS, NR.
Gb65**

Pranuar me datë: 04.04.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit, **KONSTATON** se:

- Ndryshimin dhe Plotësimin i Statutit të Komunës së Graçanicës Nr. Gb65, i datës 19.03.2013, është në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit, nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ku përcakton që administrata komunale organizohet në drejtori e jo ne departamente.
- Po ashtu ky Udhëzim për plotësim ndryshimin e statutit është në kundërshtim me nenin 12, 13, 14, të Rregullores nr. 01/13, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave dhe nenin 7 i Udhëzimit Administrativ 2008/9, për Transparencë ne Komuna.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Graçanicës që të ndërmarrin veprime konkrete që, Statuti Nr.Gb65 i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Statutit të komunës së Graçanicës të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,
Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 13.05.2013
Br. 0202-408

Za Bojan Stojanovic, Gradonačelnik Opštine Gračanica
Goran Lazic, Predsedavajući Skupštine Opštine Gračanica

**PREDMET: ZAHTEVA ZA PONOVO RAZMATRANJA ZAKONITOSTI UPUTSTVA
ZA IZMENU I DOPUNU STATUTA OPŠTINE GRAČANICA, BR. Gb65**

Priljeno dana: 04.04.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za Lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti akta , **KONSTATUJE:**

- Izmena i dopuna Statuta Opštine Gračanica Br. Gb65, od dana 19.03.2013, je u suprotnosti sa članom 62 Zakona, br. 03/L-040, za Lokalnu samoupravu koji odredjuje da opštinska administracija se organizuje na direkcije a ne na uprave .
- Takodje ovo Uputstvo za izmenu i dopunu Statuta je u suprotnosti sa članom 12, 13, 14, Uredbe br. 01/13, o Proceduri Izrade i Objavljivanja Opštinskih Akata i članu 7 Administrativnog Uputstva 2008/9, o Transparentnosti u Opštinama.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona za Lokalnu samoupravu *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Gračanica da preduzme konkretne mere ,da Statut Br.Gb65 Skupštine Opštine Gračanica, za Izmenu i Dopunu Statuta Opštine Gračanica da se uskladi sa zakonodavstvom na snazi , u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA



Kuvendi Komunal i Graçanicës

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ nr. 2008/9, të nenit 13 paragrafi 13.1 të Statutit të Komunës së Graçanicës, Kuvendi Komunal i Graçanicës, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2013, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS

Neni 1

Me miratimin e këtij udhëzimi është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës së Graçanicës, të miratuar nga Kuvendi, më datën 03.02.2010.

Neni 2

Në Statutin e Komunës së Graçanicës janë bërë ndryshimet dhe plotësimet si në vijim:


2.1 Territori i Komunës së Graçanicës përfshinë sipërfaqen prej 122,25 km²

5. 10500 Graçanicë.

6.2 6.2. Simboli i Komunës së Graçanicës përfshin karakteristikat vijuese: Baza është me ngjyrë të kaltërt të çelët, ku mesi i konturës së manastirit të Graçanicës është me ngjyrë të bardhë, në pjesën e poshtme janë petalet e kuqe të bozhurit, mbi dhe nën bazën e kaltërt gjenden dy pëlhurë me mbishkrime „URBS SPLENDISSIMA“ (Qyteti madhështor) dhe “ 1303 ” (Përmendja e parë e shkruar e emrit të Graçanicës).

6.3 Data e Ditës së Komunës së Graçanicës është më 29 dhjetor.

7.2 Vula me formë ovale përmban përgjatë rrethit të tij me shkronja të mëdha emrin “Republika e Kosovës” në tri gjuhë dhe poashtu në tri gjuhë emrin “Komuna e



Gracanics”, ndërsa në mesin e vulës gjendet simboli zyrtar i Kosovës, kurse nën vulën është shkruar në tri gjuhë “Gracanica”.

Neni 33 Konflikti i interesit

33.1 Menjëherë pas zgjedhjeve, Kryetari i komunës do ta ndërpres çdo kontratë apo veprimtari që mund të vënë në pyetje aftësinë e tij për të kryer detyrat e tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

33.2 Kryetari i komunës do të përjashtohet nga procedurat administrative apo të vendimmarrjes në lidhje me çdo çështje në të cilën ai / ajo apo ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose financiar.

33.3 Kryetari i komunës është i detyruar të shfaqë të gjitha konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

33.4 Kryetari i komunës mundet vullnetarisht të tërhiqet nga procedurat administrative apo të vendimmarrjes, në qoftë se mund të ketë konflikt të interesit.

33.5 Kryetari i komunës duhet të regjistrojë çdo ndryshim në gjendjen e tij financiare sapo ato të ndodhin.

36.1 Administrata komunale organizohet në këto departamente:

1. Kabineti i Kryetarit të komunës;
2. Departamenti i administratës së përgjithshme dhe qeshtjeve kadrovike;
3. Departamenti i buxhetit dhe financave;
4. Departamenti i zhvillimit ekonomik dhe intergimeve;
5. Departamenti i planifikimit hapësinor, kadastrës dhe mbrojtjes së mjedis;
6. Departamenti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
7. Departamenti i arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit;
8. Departamenti i shërbimeve publike, bujqësisë, pylltarisë dhe shërbimeve emergjente.
9. Departamenti i Inspektionit.

Neni 50 Shërbimi civil komunal

I. KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Kabineti i Kryetarit të komunës ka përgjegjësi të mëposhtme:

- Ofron mbështetje administrative për Kryetarin e komunës;
- Promovon zbatimin e rregullave ligjore në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën e kthimit;
- Kryen kontrollin e brendshëm të shpenzimeve buxhetore dhe siguron funksionimin ekonomik dhe efikasitetin institucional;
- Informon publikun për aktivitetet e komunës, kryetarit të komunës dhe organeve tjera komunale.

IV. DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE INTEGRIME

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- përcjellë trendet e zhvillimit ekonomik të komunës në fushën e industrisë, minierave, bujqësisë, peshkatarisë, shërbimeve të veterinarisë, pylltarisë, gjuetisë, komunikimit dhe transportit;
- merr pjesë në procesin e planifikimit të zhvillimit ekonomik komunal;
- krijon kushte për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- mbikëqyr dhe implementon politikat zhvillimore nujqësore dhe rurale;
- punon në avancimin dhe zhvillimin e turizmit dhe inkurajon turizmin rural;
- koordinon zbatimin e detyrave dhe mbikëqyr aktivitetet e administratës komunale në fushën e integrimit evropian.

V. DEPARTAMENTI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Ky departament ka këto përgjegjësi:

- hartimi i planeve zhvillimore të komunës;

VII. DEPARTAMENTI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

- Koordinon dhe mbikëqyr punën e spitalit, Qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe qendrave të tjera;

- Mbikëqyr aktivitetet në sektorin privat shëndetësor, në bashkëpunim me Departamentin e inspektionit;

VIII. DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE SHËRBIMEVE EMERGJENTE

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- Siguron ofrimin e shërbimeve publike komunale për të gjithë qytetarët në Komunën e Graçanicës, duke përfshirë furnizimin me ujë, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave të ngurta, organizimin e transportit publik;
- Organizon dhe mbikëqyr mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, shesheve, rrugëve, vendeve për parking, varrezave, ndriçimit publik dhe vendeve reklamuese;
- Monitoron dhe analizon situatën dhe rekomandon masat për zhvillimin e bujqësisë;
- Kujdeset për mbrojtjen e pyjeve dhe merret me mbrojtjen e burimeve bimore dhe të kafshëve në komunë;
- Harton planet për zhvillimin rural dhe përmirësimin e standardeve të jetesës në territorin e komunës;
- Implementon të gjitha obligimet ligjore në lidhje me reagimin e gatishmërisë në rast të emergjencave;
- Përgatit dhe zbaton planin për emergjencat dhe shpëtim në rast të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave;
- Mban programe trajnuese për ekipet e shpëtimit dhe siguron pajisjet përkatëse të nevojshme për ofrimin e ndihmës në situata emergjente;

IX. DEPARTAMENTI I INSPEKSIONIT

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- Kontrollon objektet afariste, industriale dhe komerciale dhe depot;
- Kontrollon kushtet shëndetësore dhe sanitare në objektet publike dhe komerciale, si dhe respektimin e orarit të punës të objekteve hotelierike dhe shërbyese;

- Mbron hapësirat publike nga sekuestrimi i paligjshëm.
- Monitoron sigurinë e produkteve ushqimore në procesin e prodhimit dhe qarkullimit, si dhe produktet e përdorimit të përgjithshëm;
- Ndërmerr masa lidhur me kontrollimin e ndërtimit të objekteve, në përputhje me rregullatë ligjore;
- Monitoron përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe vlerave të mbrojtura natyrore;
- Ndërmerr masa për të parandaluar ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës dhe krijimin e zhurmës, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Udhëzimi është përgjegjës Kuvendi Komunal i Graçanicës.

Neni 4

Ky Udhëzim hyn në fuqi nga data e miratimit nga ana e Kuvendit Komunal.

I dorëzohet :

- Arkivit,
- Këshilltarëve të Kuvendit Komunal,
- Të gjithë departamenteve në Komunën e Graçanicës,
- Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal.

Kryesuesi i Kuvendit

Goran Lazic





STATUTI

I KOMUNËS GRAÇANICË



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAČANICA

KUVENDI KOMUNAL I GRAÇANICËS

Sipas autorizimit të dhënë me Ligjin për vetëqeverisje lokale (Ligji Nr. 03/L-040) Kuvendi Komunal miraton, me dy të tretat e shumicës së votave statutin në vijim:

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi

1.1 Statuti i Komunës së Graçanicës është akti më i lartë ligjor i miratuar nga Kuvendi Komunal që rregullon organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Komunës së Graçanicës.

1.2 Ky Statut rregullon organizimin e brendshëm dhe funksionimin e komunës, përgjegjësitë e organeve komunale, kompetencat komunale dhe bashkëpunimin e komunës me autoritetet e tjera lokale si dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Neni 2

Territori komunal

2.1 Territori i Komunës së Graçanicës përfshin sipërfaqen prej 122, 25 km².

2.2 Në pajtim me Ligjin për kufijtë administrative të komunave, Komuna e Graçanicës ka 16 zona kadastrale, si në vijim:

ZK Badoc
ZK Batushë
ZK Çagllavicë
ZK Dobratin
ZK Graçanicë
ZK Gushtericë e Ulët
ZK Gushtericë e Epërme
ZK Llapllasellë
ZK Lepi
ZK Livagjë
ZK Preoc
ZK Skullan
ZK Sushicë

ZK Suhadoll
ZK Radevë
ZK Uglar

Neni 3

Pajtueshmëria me ligje

3.1 Komuna e Graçanicës ushtron të gjitha kompetencat e saj në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

3.2 Statuti, Rregullorja e punës, rregulloret dhe çdo akt apo aktivitet i komunës duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Neni 4

Gjuhët zyrtare

4.1 Gjuhët zyrtare të Komunës së Graçanicës janë gjuha serbe dhe gjuha shqipe. Gjuha serbe dhe gjuha shqipe si dhe alfabetet e tyre janë të barabarta në Komunën e Graçanicës.

4.2 Detajet mbi përdorimin e gjuhëve të tjera do të përcaktohen me një rregullore të posaçme, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Neni 5

Selia e Komunës

Selia e Komunës së Graçanicës gjendet në këtë adresë:

10500 Graçanicë

Neni 6

Simboli dhe Dita e komunës

6.1 Komuna ka simbolet e saj të cilët i aprovon dhe i ndryshon Kuvendi Komunal, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës dhe nuk i përngjajnë simboleve të shteteve të tjera apo simboleve të komunave të tjera brenda apo jashtë Republikës së Kosovës.

6.2. Simboli i Komunës së Graçanicës përfshin karakteristikat vijuese: Baza është me ngjyrë të kaltërt të çelët, ku mesi i konturës së manastirit të Graçanicës është me ngjyrë të bardhë, në pjesën e poshtme janë petalet e kuqe të bozhurit, mbi dhe nën bazën e kaltërt gjenden dy pëlhurë me mbishkrime „URBS SPLENDISSIMA“ (Qyteti madhështor) dhe “ 1303 “ (Përmendja e parë e shkruar e emrit të Graçanicës).

6.3. Komuna e Graçanicës ka Ditën e saj komunale. Dita e Komunës së Graçanicës është më datën 29 dhjetor. Kuvendi Komunal miraton Rregulloren e punës për festimin e Ditës së komunës në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në zbatim.

6.4. Simboli i komunës dhe Dita e komunës mund të miratohen me dy të tretat (2/3) e shumicës së Kuvendit Komunal pasi që të jetë bërë konsultim i gjerë publik.

Neni 7

7.1. Komuna e Graçanicës ka vulën në formë ovale (vezore) dhe një vulë katërkëndëshe të protokollit me karakteristikat dhe madhësinë vijuese.

7.2. Vula me formë ovale përmban përgjatë rrethit të tij me shkronja të mëdha emrin "Republika e Kosovës" në tri gjuhë dhe poashtu në tri gjuhë emrin "Komuna e Graçanicës", ndërsa në mesin e vulës gjendet simboli zyrtar i Kosovës, kurse nën vulën është shkruar në tri gjuhë "Graçanica".

7.3. Mënyra e shfrytëzimit të vulës komunale nga organet komunale përcaktohet në një rregullore të posaçme komunale.

PJESA E DYTË

KOMPETENCAT E KOMUNËS

Neni 8

8.1. Komuna e Graçanicës do të ketë të drejtë të plotë dhe ekskluzive në fushat vijuese, përderisa ato i shërbejnë interesit lokal dhe janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga legjislacioni qendror:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- v) shfrytëzimin dhe zhvillimin e tokës;
- g) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit;
- d) mbrojtjen e mjedisit në nivelin lokal;
- dj) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale lokale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- e) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- zh) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- z) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- i) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- j) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është

përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

k) banimin publik;

ll) shëndetësinë publike;

l) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

m) emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;

n) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike;

nj) turizmit;

o) aktivitetet kulturore dhe të lira;

p) çdo çështje tjetër që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e komunës dhe të gjitha ato çështjet që nuk janë eksklusivisht në kompetencë të organeve tjera.

8.2 Komuna e Graçanicës ka kompetenca të shtuara në fushat vijuese:

a) Ofrimin e shëndetësisë sekondare, duke përfshirë licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, rekrutimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e personelit të përkujdesit shëndetësor dhe administratorëve.

b) Autoritet për të ushtruar përgjegjësi për çështje kulturore, duke e përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore religjioze serbe dhe të tjera përbrenda territorit komunal, si dhe mbështetje për komunitetet lokale religjioze në pajtim me dispozitat e ligjeve në zbatim; dhe

v) Të drejta të shtuara në emërimin e komandantëve të stacionit policor siç përcaktohet në Ligjin mbi policinë.

8.3. Komuna e Graçanicës ka përgjegjësi të deleguara nga autoritetet qendrore të Kosovës në fushat vijuese:

a) shënimet kadastrale;

b) regjistrimin civil;

v) regjistrimin e votuesëve;

g) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;

d) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);)

mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

PJESA E TRETË

FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 9

9.1 Për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve dhe për t'i ushtruar përgjegjësitë nga autoritetet lokale më afër qytetarëve, komuna përmes Kuvendit Komunal apo kryetarit të komunës vendos për të bërë aranzhmane me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të saj.

9.2 Kuvendi Komunal mund të bartë përgjegjësi të caktuara fshatrave dhe organeve të tyre dhe t'u ofrojë mjete atyre organeve, më përpjesëtim me përgjegjësitë dhe aktivitetet e bartura.

9.3 Çdo fshat ka udhëheqësin e fshatit, i cili zgjedhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në rregulloren komunale për zgjedhjet në fshat. Udhëheqësi i fshatit është personi kryesor që kontakton me organet komunale. Udhëheqësi i fshatit mbledh propozimet përmes konsultimeve me anëtarët e fshatit për punët dhe aktivitetet e komunës të ndërlidhura me fshatin e tyre.

9.4 Komuna mund të hap zyra lokale nëpër fshatra për t'i ofruar shërbimet më afër qytetarëve. Zyrat lokale do të themelohen në Gustericën e Poshtme, Lepi, Llapllasellë dhe në fshatrat tjera me rregullore komunale sipas nevojës.

PJESA E KATËRT

ORGANET KOMUNALE

Neni 10

10.1 Komuna e Graçanicës ka organet vijuese:

- a. Kuvendin Komunal, kryesuesit e Kuvendit Komunal, zëvendëskryesuesin e Kuvendit Komunal dhe komitetet e Kuvendit
- b. Kryetarin e Komunës / zëvendëskryetarët e tij

10.2 Me Rregulloren komunale përcaktohen rregullat e konfliktit të interesit për të gjitha organet komunale.

Neni 11

11.1 Kuvendi Komunal i Graçanicës është organ më i lartë përfaqësues i komunës, i cili zgjedhet drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës, në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale.

11.2 Kuvendi Komunal i Graçanicës ka 19 anëtarë.

11.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal kanë të drejtë dhe përgjegjësi të barabarta në procesin e vendimmarrjes.

11.4 Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal duhet ta japin betimin solemn apo deklaratën solemne:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si anëtar i Kuvendit Komunal të Graçanicës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë qytetarët”

11.5 Anëtarët e Kuvendit Komunal të cilët nuk japin betimin apo nuk nënshkruajnë mandatin në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, brenda një muaji pas verifikimit të rezultateve të zgjedhjeve do të pushojnë të jenë anëtarë të Kuvendit.

11.6 Të gjithë anëtarët kompenzohen për shërbimin në Kuvendin dhe në komitetet e tij.

Neni 12

Mandati

12.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit Komunal është 4 vite.

12.2 Anëtari i Kuvendit Komunal pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- v) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- g) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- d) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit Komunal pa arsye;
- dj) nëse Ligji për vetëqeverisje lokale, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm diskualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

12.3 Anëtari i Kuvendit Komunal në të njejtën kohë nuk mund të jetë deputet në ndonjë komunë tjetër.

Neni 13

Të drejtat e Kuvendit Komunal

13.1 Kuvendi Komunal ka të drejtë të miratojë Statutin, Rregulloret e punës, rregulloret dhe vendimet që janë të nevojshme për t’i implementuar kompetencat komunale.

13.2 Kuvendi Komunal mund t'i delegojë disa kompetenca komiteteve të tij, kryetarit dhe trupave të tjerë dhe të njëjtin delegim mund ta tërheqë kurdoherë.

13.3 Kuvendi Komunal nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- v) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- g) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- d) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
- gj) zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal;
- e) niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- zh) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- z) emërtimin dhe ri-emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- i) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunës;
- j) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- k) përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj që duhet të ushtrohen vetëm nga Kuvendi Komunal.

Neni 14

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

14.1. Kuvendi Komunal zgjedh Kryesuesin e Kuvendit Komunal nga rradhët e anëtarëve. Votimi për Kryesues të Kuvendit Komunal bëhet me vota të fshehta.

14.2. Kryesuesi i Kuvendit Komunal zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

14.3. Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjedhet Kryesues i Kuvendit Komunal.

Neni 15

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete

15.1 Posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete është i rezervuar për komunitetin jo-shumicë në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

15.2 Posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete mbahet nga kandidati i komunitetit joshumicë, i cili ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin Komunal.

Neni 16

Detyrat e zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete

16.1. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete i komunës promovon dialogun ndërkomunal dhe shërben si person i obliguar për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në mbledhjet e Kuvendit dhe në punën e tij.

16.2 Në mungesë të kryesuesit, zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit Komunal.

16.3. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e Kuvendit Komunal të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

16.4. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete, çështjet e tilla ia paraqet Kuvendit Komunal për rishqyrtim.

16.5. Në rast se Kuvendi Komunal nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai mund ta parashtrojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim.

Neni 17

Seanca Inauguruese

17.1. Kuvendi Komunal mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

17.2. Mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

17.3. Nëse kryetari i Kuvendit të Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal mund të thirret nga anëtar i më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit Komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dëshur të thirrë mbledhjen inauguruese të Kuvendit Komunal.

17.4. Nëse anëtar i më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit Komunal.

17.5. Mbledhjet e Kuvendit Komunal që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit Komunal kryesohen nga anëtar i më i moshuar i Kuvendit Komunal që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 18

Mbledhjet e Kuvendit Komunal

18.1. Kuvendi Komunal mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e punës.

18.2. Kryesuesi i Kuvendit Komunal thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit Komunal. Kryetari apo i caktuari i tij është i obliguar të marr pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal.

18.3. Kryesuesi i Kuvendit, zëvendëskryesuesi apo të caktuarit e tij mund të ndjekin të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal.

18.4. Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
 - b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - v) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - g) rendi i ditës për mbledhje; dhe
 - d) materialet e mbledhjes.
 - gj) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.
- 18.5. Njoftimi për mbledhjen duhet t'i kumtohet publikut dhe t'i dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 19

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal

19.1. Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit Komunal caktohet nga kryesuesi apo me kërkesë të bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit Komunal apo me kërkesë të kryetarit.

19.2. E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

19.3. Të gjitha pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

19.4. Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit Komunal nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit, siç kërkohet me Rregulloren e punës,

19.5. Kushtet e njëjta procedurale që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen edhe për mbledhjet e jashtëzakonshmetë Kuvendit Komunal.

19.6. Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 20

Mbledhjet e hapura të Kuvendit Komunal

20.1 Takimet e Kuvendit Komunal dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohej pjesëmarrja në takime të Kuvendit Komunal, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës.

20.2 Kuvendi Komunal apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

- a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;
- b) takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], të cilat janë të klasifikuara si të besueshëm sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;
- v) kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale; ose
- g) informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

20.3 Në rastet e tilla, Kuvendi Komunal njofton për vendimin e marrë.

20.4 Detajet për mbledhjet e hapura të Kuvendit Komunal rregullohen me rregulloret e punës.

Neni 21

Kuorumi

21.1. Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij është më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit Komunal apo komiteteve të tij.

21.2. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

Neni 22

Rend i ditës

22.1. Rendi i ditës për takimin e Kuvendit Komunal caktohet nga kryesuesi i Kuvendit Komunal në marrëveshje me Kryetarin e komunës.

22.2. Anëtar i Kuvendit Komunal mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit Komunal, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rendin e ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

22.3. Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

22.4. Rregullorja e punës së Kuvendit Komunal rregullon detajet rreth përgatitjes, miratimit dhe ndryshimit të rendit të ditës.

Neni 23

Votimi

23.1. Në të gjitha takimet e Kuvendit Komunal dhe komitetet e tij, çdo anëtar, duke përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

23.2. Vendimet e Kuvendit Komunal apo të komiteteve të tij aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

23.3. Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuoromit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

23.4. Procesverbalet mbahen nga të gjitha takimet e Kuvendit Komunal dhe komisionet e tij dhe aprovohen në takimin e ardhshëm në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Neni 24

Konfliktet e interesit

24.1 Anëtarët e Kuvendit Komunal nuk ushtrojnë asnjë detyrë në administratën komunale.

24.2 Anëtari i Kuvendit Komunal apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

24.3 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është present. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

24.4 Para mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal, anëtarët e Kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjister publik të cilin e mbanë nëpunësi i autorizuar apo administrata komunale. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

24.5 Rregullorja e punës përcakton masat që do të ndërmerren për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikt të interesit.

Neni 25

Komitetet e përhershme

25.1. Kuvendi Komunal themelon dhe mban takime të Komitetit për politikë dhe financa dhe Komitetit për komunitete si komitete të përhershme.

25.2 Kuvendi Komunal mund të themelojë komitete të tjera apo të përkohshme për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësi të tyre.

25.3 Komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit Komunal dhe githashtu marrin parasysh përfaqësimin gjinor.

Neni 26

Komiteti për politikë dhe financa

26.1. Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në Kuvendin Komunal.

26.2 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Neni 27

Komiteti për komunitete

27.1. Komiteti për komunitete përfshinë anëtarët e Kuvendin Komunal dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve përbëjnë shumicën e komitetit të komuniteteve.

27.2 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 28

Komitetet konsultative

28.1. Kuvendi Komunal themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Në emërimin e anëtarëve në këto komunitete, Kuvendi Komunal duhet të marr parasysh përfaqësimin e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, veçanërisht ai duhet të reflektojë balancin gjinor dhe etnik të komunës.

28.2 Anëtarët e komiteteve konsultative shërbejnë për një mandat trivjeçar, ku 1/3 zgjedhet për çdo vjet. Asnjë anëtar i komitetit konsultativ nuk mund të shërbejë për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

28.3 Rregullat për emërimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të komitetit konsultativ duhet të përcaktohen me rregullore.

Neni 29

Komiteti Ad Hoc për të kthyerit

29.1 Kuvendi Komunal themelon komitetin Ad hoc për të kthyerit, i cili merret me çështjen e të kthyerëve të të gjitha komuniteteve dhe komunikon me organet shtetërore dhe ato ndërkombëtare që merren me të kthyerit.

29.2 Ky komitet përbëhet prej shtatë anëtarëve që përfaqësojnë të gjitha komunitet që jetojnë në komunë.

29.3 Mandati i këtij komiteti është pesë vjet, nëse nuk ndryshohet me vendim të Kuvendit.

Neni 30

Kryetari i komunës

30.1. Kryetari i komunës zgjedhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

30.2 Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare.

30.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon:

- a) kur ta kryejë mandatin e tij;
- b) nëse vdes;
- v) nëse jep dorëheqje;
- g) nëse ndrron vendbanimin në komunë tjetër;
- d) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- dj) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;
- e) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike;
- zh) në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Neni 31

Betimi

31.1 Me rastin e zgjedhjes, kryetari e jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të kuvendit të komunës. Teksti i betimit është si në vijim:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’iushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Graçanicës me nder, bënësikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

31.2 Kryetari që dështon ta japë betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve e humbet mandatin.

Neni 32

Përgjegjësitë e kryetarit

32.1 Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikqyr administrimin financiar të komunës;
- v) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit Komunal apo komiteteve të tij;
- g) ekzekuton aktet e Kuvendit Komunal;
- d) emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
- dj) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- e) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- zh) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin Komunal;
- z) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- ij) raporton para Kuvendit Komunal për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi Komunal;
- j) mund të kërkojë që Kuvendi Komunal ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti është në kundërshtim me ligjet në zbatim.

k) do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo-shumicë;

ll) aktivitetet tjera që i caktohen nga Kuvendi Komunal.

32.2 Kryetari raporton për punën e degës së ekzekutivit çdo tre muaj. Përveç raporteve tremujore, kryetari mund të raportojë përmes zëvendëskryetarëve të tij apo të zyrtarëve të caktuar.

Neni 33

Konflikti i interesit

33.1 Menjëherë pas zgjedhjeve, Kryetari i komunës do ta ndërpres çdo kontratë apo veprimtari që mund të vënë në pyetje aftësinë e tij për të kryer detyrat e tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

33.2 Kryetari i komunës do të përjashtohet nga procedurat administrative apo të vendimmarrjes në lidhje me çdo çështje në të cilën ai / ajo apo ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose financiar.

33.3 Kryetari i komunës është i detyruar të shfaqë të gjitha konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

33.4 Kryetari i komunës mundet vullnetarisht të tërhiqet nga procedurat administrative apo të vendimmarrjes, në qoftë se mund të ketë konflikt të interesit.

33.5 Kryetari i komunës duhet të regjistrojë çdo ndryshim në gjendjen e tij financiare sapo ato të ndodhin.

Neni 34

Zëvendëskryetari i komunës

34.1 Kryetari i Komunës ka një nënkryetar.

34.2 Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari për të njëjtin mandat si kryetari i komunës.

34.3 Me kërkesë të kryetarit, nënkryetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

34.4 Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

34.5 Dispozitat e këtij statuti për konfliktin e interesave të kryetarit të komunës zbatohen mutatis mutandis për nënkryetarin e komunës.

Neni 35

Nënkryetari për komunitete

35.1. Kryetari gjithashtu ka nënkryetarin e komunës për komunitete nga rradhet e komunitetit joshumicë, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

35.2 Nënkryetari i komunës për komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetarit të komunës.

35.3 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për komunitete propozohet nga Kryetari i komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve joshumicë.

35.4 Nënkryetari për komunitete do t'i ndihmojë kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

35.5 Kur posti i nënkryetarit për komunitete mbetet i lirë, kryetari i komunës propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

35.6 Dispozitat e këtij Statuti për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohen mutatis mutandis për nënkryetarin e komunës për komunitete.

Neni 36

Departamentet e administratës komunale

36.1 Administrata komunale organizohet në këto departamente:

1. Kabineti i Kryetarit të komunës;
2. Departamenti i administratës së përgjithshme dhe çështjeve kadrovike;
3. Departamenti i buxhetit dhe financave;
4. Departamenti i zhvillimit ekonomik dhe intergimeve;
5. Departamenti i planifikimit hapësinor, kadastrës dhe mbrojtjes së mjedis;
6. Departamenti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
7. Departamenti i arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit;
8. Departamenti i shërbimeve publike, bujqësisë, pylltarisë dhe shërbimeve emergjente.
9. Departamenti i Inspektionit.

36.2 Fushëveprimi i punës për çdo departament është dhënë në shtojcën I. të këtij statuti. Departamentët ndahen në sektor me përshkrime të detajuara të punës të cilat do të renditen në një akt të posaçëm të kryetarit.

36.3 Çdo departament komunal menaxhohet nga drejtori, i cili punësohet dhe largohet nga kryetari i komunës.

36.4 Drejtorët menaxhojnë departamentet e tyre në pajtim me udhëzimet politike dhe strategjike të kryetarit të komunës, me këtë statut, ligjet dhe rregulloret komunale.

36.5 Drejtorët rregullisht i raportojnë kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij informacionet e nevojshme dhe raportet për procesin e vendim-marrjes.

Neni 37

Largimi i kryetarit

37.1. Qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës.

37.2 Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzetë (20) përqind e votuesëve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.

37.3 Nëse shumica e votuesëve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të mbahen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet okale.

PJESA E PESTË

KONSULTIMET PUBLIKE DHE PJESËMARRJA

Neni 38

Konsultimi publik

38.1 Kuvendi Komunal konsulton publikun para marrjes së ndonjë vendimi, në mënyrë që të sigurojë përfshirjen e brengave të publikut.

38.2 Kuvendi Komunal përkujdeset që qytetarët të kenë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre dhe se kërkesat e tyre dhe interesat të merren parasysh para se të merret ndonjë vendim.

Neni 39

Format e konsultimit

Komuna mund të përdorë, në mes tjerash, format vijues të konsultimit që janë listuar siapas nevojave dhe rrethanave:

1. Kampanja të publicitetit dhe të informimit për promovimin e programeve komunale dhe aktiviteteve;
2. Kontaktet me fokus grupet, për të testuar dhe diskutuar politikat;
3. Pyetësorët për implementimin e politikave;m
4. Shpallja publike e propozimeve për politikat dhe rregulloret si dhe thirrja e publikut për pjesëmarrje dhe përfaqësim;
5. Kontaktet dhe mbledhjet me grupet e interesit;
6. Mbledhjet publike;
7. Dëgjimet publike; apo
8. Hulumtimet për vlerësim efikas.

Neni 40

Mbajtja dhe publikimi i konsultimeve

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, kryetari dhe anëtarët e Kuvendit Komunal kanë të drejtë për të mbajtur konsultime publike për çdo çështje që është në kompetencë të tyre. Rezultatet e konsultimeve dotë shqyrtohen dhe të bëhen publike para marrjes së vendimit.

Neni 41

Komuna siguron transparencë të nevojshme dhe miraton mekanizma të komunikimit në mënyrë që të përmbushë interesat e publikut. Pa përjashtuar mënyrat e tjera të komunikimit, konsultimet e hapura publike do të publikohen në ueb-faqet zyrtare të komunës.

Neni 42

Vendi dhe koha e konsultimeve

42.1 Komuna mban, së paku, dy mbledhje publike në vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe tjetrën në gjashtëmujorin e dytë.

42.2 Vendi, data dhe koha e mbledhjes publike duhet të bëhet publike, së paku, dy javë para mbajtjes së mbledhjes.

42.3 Përfaqësuesëve të mediave mund t'u lejohet pjesëmarrja në të gjitha mbledhjet publike.

Neni 43

Kryetari apo përfaqësuesi/esja e tij/saj kryeson mbledhjen me publikun. Ai/ajo ka të drejtë të vendosë për procedurën e mbajtjes së mbledhjes. Detajet e mbledhes duhet të përcaktohen me rregullore komunale.

Neni 44

Referendumi lokal

Qytetarët mund të kërkojnë që rregulloret e kuvendit komunal t'i nënshtrohen referendumi lokal nëse kërkesa nënshkruhet nga, së paku, 10% e votuesëve të regjistruar në komunë. Detajet duhet të përcaktohen me rregullore komunale.

Neni 45

Iniciativa civile

Qytetarët mund të kërkojnë që Kuvendi Komunal të miratojë, ndryshojë, shfuqizojë rregullore komunale të cilat janë në kompetencë të komunës nëse iniciativa nënshkruhet nga 10% e votuesëve të regjistruar në komunë. Detajet përcaktohen me rregullore komunale.

PJESA E GJASHTË

PARTNERITETI KOMUNAL, PROCEDURAT BUXHETORE DHE SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 46

46.1 Pas konsultimeve me Komitetin për politikë dhe financa, kryetari i komunës ia prezanton rekomandimet Kuvendit Komunal për marrëdhënie ndërkomunale dhe partneritete.

46.2 Kuvendi Komunal vendos për marrëveshjet ndërkomunale dhe partneritetet.

Neni 47

Kryetari pas konsultimeve me Komitetin për politikë dhe financa ia prezanton rekomandimet Kuvendit Komunal lidhur me marrëveshjet e propozuara ndërmjet më shumë komunave për menaxhimin e kompanive komunale për mbikqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike që ofrohen nga më shumë se një komunë.

Neni 48

Kuvendi Komunal mund të punojë me Kuvendet e komunave tjera për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

Neni 49

Financat komunale dhe procedurat buxhetore

49.1 Komuna e Graçanicës ka burimet e veta financiare dhe buxhetin për t'i kryer kompetencat sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për financat e pushtetit lokal.

49.2 Të gjitha çështjet që janë të ndërlidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e kryetarit të komunës.

49.3 Kryetari i komunës mund t'i delegojë përgjegjësitë për administrim financiar nënkryetarit apo ndonjërit nga drejtorët e departamenteve komunale.

Neni 50

Shërbimi civil komunal

50.1 Shërbimi civil komunal organizohet në bazë të parimeve dhe procedurave të ligjit mbi shërbimin civil dhe ligjeve të tjera relevante. Detajet përcaktohen me rregullore.

50.2 Kur punësohet personeli i komunës, duhet të rrespektohen procedurat transparente dhe konkurruese për punësimin e kandidatëve në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 51

Administrata komunale e ka udhëheqësin e personelit i cili rekrutohet nga kryetari në pajtim me procedurat e ligjit në fuqi për shërbimin civil.

Neni 52

Procedurat e punësimit të shërbyesve civil mbikqyren nga udhëheqësi i personelit dhe ato dueht të përkujdesen që përbërja e shërbyesve civil të reflektojë balancin gjinor dhe etnik.

PJESA E SHTATË

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Ky Statut hyn në fuqi me aprovimin e tij nga dy e treta e shumicës së Kuvendit Komunal dhe pas nënshkrimit të tij nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Neni 54

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, të gjitha aktet apo rregulloret e komunës të cilat janë në kundërshtim me këtë statut do të shfuqizohen.

Neni 55

54.1. Propozimin për ndryshim të këtij statuti mund ta iniciojë:

- a) Kryetari
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit Komunal
- v) Peticion i 15% të qytetarëve të komunës me të drejtë vote

55.2. Propozimi për ndryshim të statutit i dorëzohet kuvendit komunal për diskutim paraprak. Kuvendi komunal e diskuton propozimin me publikun para se të marrë vendim përfundimtar rreth propozimit.

55.3. Pas konsultimit publik, Kuvendi Komunal vendos për ndryshimin e propozuar.

55.4. Statuti konsiderohet i ndryshuar nëse propozimi për ndryshim miratohet nga dy e treta e shumicës së votave të Kuvendit Komunal.

Neni 56

Interpretimi përfundimtar i këtij statuti bëhet nga Kuvendi Komunal.

Graçanicë, mars 2013

SHTOJCA I DEPARTAMENTET KOMUNALE

I. KABINETI I KRYETARIT

Kabineti i Kryetarit të komunës ka përgjegjësi të mëposhtme:

- Ofron mbështetje administrative për Kryetarin e komunës;
- Promovon zbatimin e rregullave ligjore në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën e kthimit;
- Kryen kontrollin e brendshëm të shpenzimeve buxhetore dhe siguron funksionimin ekonomik dhe efikasitetin institucional;
- Informon publikun për aktivitetet e komunës, kryetarit të komunës dhe organeve tjera komunale.

II. DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE ÇËSHTJEVE KADROVIKE

Ky Departament ka këto përgjegjësi:

- mbikqyr tërë administratën komunale, disiplinën e personelit;

- ofron dhe mirëmban shërbime për funksionim efikas të komunës, siç janë automjetet, telefoni, nxemja, ftohja dhe sistemet e tjera;
- mban shënime për të punësuarit siç janë pushimet, pushimet mjekësore, masat disiplinore, trajnimet e ndjekura dhe të dhëna të tjera,
- ofron ndihmë teknike dhe profesionale për kryetarin dhe kuvendin komunal sipas;

III. DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- përpilon rregullore komunale për financa dhe ekonomi;
- ndihmon kryetarin në procesin e përgatitjes së buxhetit;
- mirëmban kontabilitetin vjetor dhe librat financiare ;
- monitoron procedurat e ekzekutimit të buxhetit dhe sistemet;
- përgatit procedurat e kontabilitetit dhe raportet;
- ofron këshilla profesionale për çështjet buxhetore organeve të tjera komunale;
- planifikon, përcakton nivelin e tarifave, taksave dhe pagesave para se ato të hyjnë në rregulloren komunale;
- mban regjistrin e vjeljes së të hyrave vetanake.

IV. DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE INTEGRIME

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- përcjellë trendet e zhvillimit ekonomik të komunës në fushën e industrisë, minierave, bujqësisë, peshkatarisë, shërbimeve të veterinarisë, pylltarisë, gjuetisë, komunikimit dhe transportit;
- merr pjesë në procesin e planifikimit të zhvillimit ekonomik komunal;
- krijon kushte për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- mbikqyr dhe implementon politikat zhvillimore nujqësore dhe rurale;
- punon në avancimin dhe zhvillimin e turizmit dhe inkurajon turizmin rural ;

- koordinon zbatimin e detyrave dhe mbikëqyr aktivitetet e administratës komunale në fushën e integritetit evropian.

III. DEPARTAMENTI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT, KADASTRËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Ky departament ka këto përgjegjësi;

- hartimi i planeve zhvillimore të komunës;
- Harmonizon planet komunale hapësinore dhe urbane;
- Përpilon planet zhvillimore urbane, planet rregullative urbane dhe përcjellë implementimin e tyre;
- Mbledh dhe mban të dhëna për zhvillimin hapësinor në pajtim me ligjin në zbatim;
- Përcakton kushtet arkitektonike dhe urbane për ndërtesat brenda territorit komunal;
- Jep leje të ndërtimit;
- Propozon lokacionet për shfrytëzim të tokës dhe eksproprijim;
- Jep leje për ndërtim dhe revokim të tyre;
- Jep leje për shfrytëzimin e ndërtimeve të përfunduara dhe kontrollon kushtet teknike;
- Bënë matjet kadastrale dhe hartat;
- Mirëmban dhe përditëson regjistrin e pasurisë së paluajtshme;
- Mirëmban arkivin fizik dhe elektronik të hartave gjeodezike;
- Implementon të gjitha vendimet komunale në fushën e përgjegjësisë së tij;
- Ndërmerr masa për të mbrojtur biodiversitetin në territorin komunal;
- Mbledh të dhëna dhe ruan burimet të ujit dhe të ujërave nëntokësore;
- Inspekton implementimin e standardeve të kontrollit të zhurmës, nivelet e ndotjes dhe shkallën e rrezatimit;

- Implementon të gjitha dispozitat ligjore të ndërlidhura me mbrojtjen e ambientit.

IV. DEPARTAMENTI I ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- vendos për numrin e objekteve parashkollore, fillore, të mesme dhe objekteve të edukimit special si dhe zgjerimin e tyre;
- propozon emërimin e objekteve parashkollore, fillore, të mesme dhe të edukimit special si dhe zgjerimin e tyre;
- bënë mbikqyrje profesionale dhe pedagogjike në nivelin parashkollor, fillor, të mesëm dhe special
- organizon procesin e mësimdhënies në nivelin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të edukimit special si dhe zgjerimin e tyre
- Emëron drejtorët e shkollave për të gjitha nivelet;
- Përkujdeset për kushtet e punës së mësuesve dhe stafit mbështetës të shkollave si dhe për shpenzimet dhe investimet
- Propozon programe për avancim profesional të mësuesve dhe stafit administrativ të institucioneve edukative;
- Organizon programe për edukim dhe rekreacion të të rinjëve;
- Sponzoron dhe organizon festivale, gara, kampe të të rinjëve dhe aktivitete të ngjashme;
- Mbikqyr dhe mirëmban objektet sportive,
- Organizon të gjitha ngjarjet sportive brenda komunës apo jashtë saj me ekipet komunale të sportit.

V. DEPARTAMENTI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- Ofrimin e përkujdesit primar dhe sekondar shëndetësor dhe monitorimin e situatës së përgjithshme shëndetësore në komunë;
- Miraton politika lidhur me planifikimin dhe financimin e përkujdesit shëndetësor;
- Koordinon dhe mbikqyr punën e spitalit, Qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe qendrave të tjera;

- Mbikëqyr aktivitetet në sektorin privat shëndetësor, në bashkëpunim me Departamentin e inspektionit;
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e Qendrës për mirëqenien sociale;
- Ushtron aktivitete të tjera në fushën e përkujdesit shëndetësor dhe mirëqenies sociale siç parashihet me ligjin në fuqi;
- Zhvillon një plan strehimor për territorin e komunës.

VII. DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE SHËRBIMEVE EMERGJENTE

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- Siguron ofrimin e shërbimeve publike komunale për të gjithë qytetarët në Komunën e Graçanicës, duke përfshirë furnizimin me ujë, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave të ngurta, organizimin e transportit publik;
- Organizon dhe mbikëqyr mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, shesheve, rrugëve, vendeve për parking, varrezave, ndriçimit publik dhe vendeve reklamuese;
- Monitoron dhe analizon situatën dhe rekomandon masat për zhvillimin e bujqësisë;
- Kujdeset për mbrojtjen e pyjeve dhe merret me mbrojtjen e burimeve bimore dhe të kafshëve në komunë;
- Harton planet për zhvillimin rural dhe përmirësimin e standardeve të jetesës në territorin e komunës;
- Implementon të gjitha obligimet ligjore në lidhje me reagimin e gatishmërisë në rast të emergjencave;
- Përgatit dhe zbaton planin për emergjencat dhe shpëtim në rast të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave;
- Mban programe trajnuese për ekipet e shpëtimit dhe siguron pajisjet përkatëse të nevojshme për ofrimin e ndihmës në situata emergjente;

VIII. DEPARTAMENTI I INSPEKSIONIT

Ky departament është përgjegjës për këto detyra:

- Kontrollon objektet afariste, industriale dhe komerciale dhe depot;

- Kontrollon kushtet shëndetësore dhe sanitare në objektet publike dhe komerciale, si dhe respektimin e orarit të punës të objekteve hotelierike dhe shërbyese;
- Mbron hapësirat publike nga sekuestrimi i paligjshëm.
- Monitoron sigurinë e produkteve ushqimore në procesin e prodhimit dhe qarkullimit, si dhe produktet e përdorimit të përgjithshëm;
- Ndërmerr masa lidhur me kontrollimin e ndërtimit të objekteve, në përputhje me rregullatë ligjore;
- Monitoron përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe vlerave të mbrojtura natyrore;
- Ndërmerr masa për të parandaluar ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës dhe krijimin e zhurmës, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Kryetari i Kuvendit Komunal

